



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:281614

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05755253

K.DH.SH.II.nr.1310/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Klinika Gjinekologjike Gjermane “Deutche Frauenklinik” me seli në Prishtinë magjistrala Prishtinë-Ferizaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hamdi Podvorica, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë/ Inspektoratit Shëndetësor me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.161/22, të datës 22.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Klinika Gjinekologjike Gjermane “Deutche Frauenklinik” me seli në Prishtinë magjistrala Prishtinë-Ferizaj e datës 25.07.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.161/22, të datës 22.06.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Klinika Gjinekologjike Gjermane “Deutche Frauenklinik”, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 05-1493 të datës 01.04.2019 si dhe vendimin nr. 05-1753/2 të

datës 25.04.2019 i nxjerrë nga i padituri Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë si dhe kthimin e gjobës së paguar në shumë prej 5,000.00€. Ndërsa, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja ka paraqitur ankesë përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të aprovon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ose ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e pa-bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor, në Prishtinë, nr.10/ND-010 të datës 29.03.2019, nën pikën I. të dispozitivit është vendosur, Dr. O.C., i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si profesionist shëndetësor qytetar jo-kosovar deri në licencimin nga Ministria e Shëndetësisë. Në pikën II. Për shkelje të dispozitave ligjore të lartshënuara dënohet me vlerë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro. Në pikën III. Pagesa e gjobës së shqiptuar bëhet në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në xhirollogarinë e Ministrisë së Shëndetësisë me numër 1000-4000-7000-2508- MSH 11330. Në pikën IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kundër vendimit përfundimtar të organit administrativ paditësi me padi inicicion konflikt administrativ në procedurë gjyqësore, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 15.06.2023, dhe administrimit të provave të theksuara si në aktgjykimin e saj, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, duke iu referuar dispozitave ligjore sipas Ligjit për Shëndetësinë, ka gjetur se padia e paditësit është e pa bazuar, në arsyetim ndër tjera ka theksuar Gjykata vlerëson se paditësi nuk i është përmbajtur UA Nr. 06/2012 të MSH për Licencim të Përkohshëm të Profesionistëve Shëndetësor qytetar jo-Kosovar, me rastin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pacientë pa leje të përkohshme pune nga Dr. O.C. qytetar jo Kosovar. Me rastin e ofrimit të shërbimeve nga Dr. O.C. në këtë klinikë pa leje ka rënë në kundërshtim me nenin 2 par. 1 të UA Nr.06/2012 të MSI-I në të cilin përcaktohet se "Institucioni shëndetësor, publik apo privat, i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, që angazhon profesionistin shëndetësor qytetarjo- kosovar, ka për obligim të parashtroj kërkesën për leje të përkohshme pune" dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton që "Kërkesës duhet bashkangjitur: 2.1. Lejen e punës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në pajtim me Ligjin për dhënien e lejes së Punës shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës "i Në këtë rast ka rezultuar se paditësi me rastin e angazhimit të profesionistit shëndetësor qytetar jo - kosovar Dr. O.C. për shërbimin e pacientëve pa lejen e përkohshme të lëshuar nga MPMS në pajim me Ligjin për dhënien e lejes së Punës shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, dhe pa lejen e përkohshme të punës të lëshuar nga Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim, ashtu që ka rënë në kundërshtim me kushtet për ofrimin e shërbimeve për pacientët sa i përket kushteve të punës për profesionistet shëndetësor qytetarët jo kosovar. Gjykata po ashtu nga prova regjistri i pacientëve i dorëzuar si fotografi nuk arriti të konstatojë në mënyrë të qartë faktin se kush ka qenë doktori përgjegjës për pacientët me numër regjistrimit 42 dhe 43, ndërsa përfaqësuesi i paditësit përkundër që me parashtresën e datës 24.05.2023 kishte propozuar dorëzimin e provës përkatësisht dorëzimin në origjinal të regjistrimit të pacientëve, por në seancën e datës 15.06.2023 nuk e kishte bërë dorëzimin. Gjithsesi, gjykata në këtë rast, duke marrë për bazë edhe deklaratimet e palëve në seancën e datës 17.05.2023 vlerësoi se nuk ishte kontestues fakti se Dr. O.C. qytetar-Kosovar, ka qenë prezent në sallë operative për pacientin me numër 42, por nga përfaqësuesi i paditësit ishte kontestuar fakti se i njëjti ka ofruar shërbime mjekësore me arsyetimin se i njëjti ka qenë prezent në sallë në kuadër të vizitave të institucioneve që kanë për qëllim aftësimin e mjekëve dhe ngritjen e tyre profesionale në përputhje me nenin 75 par.5 të Ligjit për Shëndetësi, ku përcaktohet obligimi për të marrë pjesë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Lidhur me këtë, gjykata ju referua nenit 75 të Ligjit për Shëndetësi i cili përcakton se: "I, Profesionistët shëndetësorë obligohen që të marrin pjesë në

zhvillimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes së kualifikimeve të tyre profesionale, 2 Institucionet shëndetësore janë të obliguara që të mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë, në pajtim me këtë ligj dhe aktet e përgjithshme të institucionit. 3. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dokumentohet me Kredit e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) të evidentuara në portfolion personale, 4. Numri i krediteve të ZHVP, llojet e trajnimeve, legjitimiteti i institucioneve për të ofruar kredite të ZHVP, dhe çështjet e tjera relevante për zhvillimin e vazhdueshëm profesional do të jenë në autoritetin e Odës përkatëse të profesionistëve shëndetësorë nga neni 78 i këtij ligji,” por nga kjo dispozitë gjykata konstatoi se Institucionet shëndetësore janë të obliguara që të mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional në pajtim me ligjin, ndërsa dispozitat ligjore përcakton detyrimin që qytetar jo-Kosovar të pajisjen me leje pune nga MPMS dhe Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu dispozita e lartcekur i referohet zhvillimi i vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësor, ndërsa në rastin konkret, paditësi nuk e ka provuar me ndonjë provë se cili profesionist shëndetësor ka qenë përgjegjës në sallën operative për pacientin nr. 42, nëse Dr. O.C. ka qenë prezent në kuadër të vizitave të institucioneve që kanë për qëllim aftësimin e mjekëve dhe ngritjen e tyre profesionale. Prandaj, gjykata vlerëson se Kryeinspektori Shëndetësor ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur me vendimin nr. Prot 05-1753/2 të datës 25.04.2019 me nr. Ref AM-001-19 të datës 25.04.2019 ka refuzuar ankesën e paditësit kundër Vendimit nr. 10/ND-009-19 të datës 29,03.2019 me të cilën paditësin e dënua me gjobë në shumë prej 5,000€, pasi që dispozitat e lartcekura përcaktojnë obligimin e qartë për institucionet shëndetësore që qytetar jo- kosovar për ofrimin e shërbimeve mjekësore në Kosovë duhet të pajisjen me leje pune nga organet përgjegjëse.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se me rastin e refuzimit të kërkesë padisë së paditësit në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale dhe drejtë është vlerësuar ligjshmëria e vendimit të organit të paditur si në vështrim të nenit 41 dhe 44 të LKA-së, sepse organi administrativ i shkallës së parë i Inspektoratit Shëndetësor, ka konstatuar se nga inspektimi i kryer në IPSH Deutsche Frauenklinik kishte konstatuar se ky institucion ishte i pajisur me licencë për ofrimin e shërbimeve gjinekologjike me obstetrike, neonatologji dhe ishte i pajisur me laborator biokimik me hematologji, ivf laborator, embriologji, janë kontrolluar regjistri i vizitave ditore, regjistri i

sallës dhe regjistri i të porsalindurve i cili nuk është mbajtur sipas UA 02/2010, po ashtu është konstatuar se dosjet e IVF nuk kanë qenë të kompletuara, mungojnë pëlqimet nga psikologu, urologu, juristi dhe se Dr. O.C. ka ofruar shërbime shëndetësore kjo gjë është konstatuar nga shënimet e tij në regjistër.

Po ashtu është konstatuar se gjatë kryerjes së inspektimit në sallën operative ka qenë i pranishëm doktori i huaj i cili kishte ofruar shërbime Dr. O.C.- specialist gjinekologjik qytetar jo Kosovar pa vendim të MSH-së (i cili nuk ka pasur licencë — leje Pune) në Kosovë, gjithashtu në këtë proces ishin konstatuar edhe mungesa të tjera si biokimisti, pajisjet për ofrimin e shërbimit të biokimisë dhe reagensët të cilët nuk ishin adekuat (mungojnë aparaturat përkatëse si dhe punojnë me teste të gatshme). Duke marrë parasysh konstatimet e bëra si rekomandime ishte dhënë që të ndalohet ofrimi i shërbimit shëndetësor nga Dr. O.C. — specialist gjinekologjik qytetar shtetas jo Kosovar si person i pa autorizuar pa vendim të MSH-së, të ndalohet ushtrimi i veprimtarisë si biokimist nga z. Z.G., inxhinier i diagnostikës laboratorike - mjeksore, të ndalohet ofrimi i veprimtarisë shëndetësore në shërbimin e laboratorit biokimik hematologjik, për shkak të mungesës së profesionistit shëndetësor dhe plotësimin e kushteve për këtë shërbim sipas par 1.5 të neni 31 i UA 09/2014 dhe gjithashtu ishte rekomanduar edhe ndalimi i ofrimit të shërbimit nga Dr. F.K. pa qenë i lajmëruar në DLA. Andaj, në këtë rast e paditura Inspektorati Shëndetësor me vendimin nr.10/ND-010 i datës 29.03.2019 kishte vendosur që Dr. O.C., ti ndalohet ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si profesionist shëndetësor qytetar-jo Kosovar deri në licencim nga Ministria e Shëndetësisë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të nenit 71 par. 3 dhe 4 të Ligjit për Shëndetësi nr.04/L-125 dhe nenin 5 par. 2 të UA 06/2012 për licencim të përkohshëm të profesionistëve shëndetësor qytetar jo kosovar. Kolegji vlerëson se organi i shkallës së parë me të drejtë paditësin e ka dënuar me gjobë në shumë prej 5,000€, pasi që dispozitat e lartcekura përcaktojnë obligimin që qytetar jo kosovar për ofrimin e shërbimeve mjekësore në Kosovë duhet të pajisjen me leje pune nga organet kompetente.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative dhe përmban të meta për shkak të cilave aktgjykimi i ankimuar nuk mund të ekzaminohet, është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk ka arsye fare për faktet vendimtare, ose ato që janë paraqitur janë kontradiktore dhe ka kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen

e procesverbaleve për thëniet e dhëna në procedurë dhe vetë atyre dokumenteve dhe procesverbalit. Kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe vlerëson se janë të pa bazuara në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike të çështjes në shqyrtim, dhe jo me ndikim për vendosjen ndryshe sepse aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të LKA, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë si në vendimet e organi të paditur të konfirmuara si ligjore dhe në procedurë gjyqësore, pasi që paditësi ka ofruar shërbime shëndetësore pa u pajisur me leje pune nga organet kompetente, duke vepruar kështu në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ UA. Nr.06/2012 të Ministrisë së Shëndetësisë për Licencimin e përkohshëm të profesionistëve shëndetësor qytetar jo kosovar. Ndërsa, sa i përket pretendimit në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë e të plotë gjendjen faktike, provat e përmendura janë shikuar një nga një në shqyrtim gjyqësor nga gjykatësi nuk ka bërë vërejtje se provat e pranuar nuk janë të lexueshme apo se nuk mund të deshifrohet ndonjë fakt në ndonjë pjesë të provave. Po ashtu ka konsideruar se vendimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë i të paditurës si dhe tani aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të gjitha janë të pa drejta dhe të paligjshme. Kolegji këto pretendime nuk i aprovoi pasi që vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga e paditura duke zbatuar dispozitat e Ligjit për Shëndetësinë dhe Udhëzimit Administrativ, kolegji ka vlerësuar se me Ligjin nr. 04/L-125 për shëndetësi në nenin 75 përcaktohet: *“1. Profesionistët shëndetësorë obligohen që të marrin pjesë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes së kualifikimeve të tyre profesionale. 2. Institucionet shëndetësore janë të obliguara që të mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë, në pajtim me këtë ligj dhe aktet e përgjithshme të institucionit. 3. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dokumentohet me Kredit e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) të evidentuara në portfolion personale. 4. Numri i krediteve të ZHVP, llojet e trajnimeve, legjitimiteti i institucioneve për të ofruar kredite të ZHVP, dhe çështjet e tjera relevante për zhvillimin e vazhdueshëm profesional do të jenë në autoritetin e Odës përkatëse të profesionistëve shëndetësorë nga neni 78 i këtij ligji”*. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në këtë çështje juridike administrative, nga organi administrativ përfundimtar, Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati i Shëndetësisë dhe Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila

rezulton se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, aktgjykimi i ankimuar është i kuptueshëm përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i miraton edhe kolegji duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë, andaj i njëjti vërtetohet në tërësi si i drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1310/23, me datë 30.05.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**